
TRIBUNA SINDIKALE

Dhjetor 2007

Dhe drit' e diturisë përpara do na shpjerë





Editorial

DIALOGU SOCIAL, OBJEKTIVI YNE KRYESOR PER VITIN 2008

Ditet e fundit te vitit sjellin atmosfeen e festave: Kurban Bajrami, pasataj Krishtlindjet, pastaj Viti I Ri. Ne kete atmosfere jetojne te gjithe, jetojne edhe mesuesit. Kryesite e te dy Sindiktave Qendore te Arsimit pershendesin perzemersisht anetaret e tyre, pershendesin dhe urojne te gjithe mesuesit dhe nxenesit: Gezuar festat e fundvitit, suksese, shendet e mbaresi per Vitin e Ri 2008 !

Krahas urimit te zakonshem, por te merituar dhe te perzemert per cdo sindikalist, per cdo mesues e pedagog, per drejtuesit e cdo niveli ne piramiden e sistemit te arsimit, FSASH e SPASH, duke u pergatitur per te hedhur hapin ne vitin 2008, u percjellim atyre edhe nje mesazh, pikerisht mesazhin e angazhimit te sindikatave te arsimit ne mbrotje te interesave dhe kerkesave sociale ekonomike te anetareve, te mesuesve e pedagogeve sindikaliste si dhe te kryerjes me pergjegjesi te rolit te partnerit social per reformimin dhe modernizimin e shkolles, per nje arsim cilesor publik, qe u mundeson te gjithe femijeve dhe brezit te ri shanse te barabarta.

SPASH dhe FSASH jane te vendosura qe gjate vitit 2008 te zgjidhin me Ministrine e Arsimit dhe Shkences dhe me Qeverine disa nga kerkesat e rendesishme qe jane pranuar dhe perfshire ne Kontraten Kolektive te Punes dhe qe lidhen me:

- Permiresimin e sistemit te shperblimeve te mesuesve, duke motivuar me te dalluarit, ata qe arrijne rezultate cilesore ne procesin mesimor, qe u qendrojne afer nxenesve dhe ndertojne marredhenie korrekte me ta, duke punuar edhe jasht kohes normale te punes, qe jane aktive ne jeten e shkolles, por edhe jashte saj, ne mardhenie me komunitetin, deri edhe me prinderit e nxenesve qe paraqesin probleme, qe perfeksionojne panderprerje kualifikimin e tyre.

- Njohjen e shteses se pages per vjetersi ne masen 2 perqind per cdo vit pune dhe jo vetem per vitet e punesimit ne arsim.

- Zgjidhjen e mospajtimit me Ministrine e Financave per dhenien e mesuesve qe dalin ne pension deri ne dy paga mujore.

- Miratimin e nje drafti per Statusin e Mesuesit.

Pervec angazhimit per zgjidhjen e ketyre kerkesave, ne radhe te pare nepermjet dialogut , FSASH dhe SPASH do te vazhdojne porcesin e nisur per forcimin e kapaciteteve te te gjithe strukturave drejtuese nga qendra deri ne baze, do te forcojne e konsolidojne strukturat e seksioneve te gruas dhe te rinise ne sindikate, do te zgjerojne e thellojne veprimtarite per kualifikimin professional e sindikal te strukturave drejtuese dhe anetareve, si dhe do te pasurojne e zhvillojne me tej pervojen e tyre tashme te mirenjohur per rritjen e interesit te nxenesve per shkollen dhe parandalimin e eliminimin e formave te keqia dhe te demshme te punes se femijeve

Por objektivat dhe synimet tona ne marredhenie me punedhenesin dhe me vetveten, pra per fuqizimin e sindikatave, lidhen dhe kushtezohen nga zhvillimi i nje dialogu social te vazhdueshem, te pergjegjshem dhe te efektshem ne te gjitha nivelet. Nese dialogu funksionon ne pergjithesi mire ne nivelin e pare, duke u mbeshtetur ne Kontraten Kolektive te Punes dhe ne permiresimet e plotesimet qe duhet t'i behen asaj, ne nivelin e dyte, ne marredheniet midis Seksioneve Sindikale ne qarqe e rrethe te te dy sindikatave dhe te DAR e ZA, me pak perjashtime, dialogu zhvillohet me hope, eshte formal dhe palet nuk marrin mbi vete angazhime e pergjegjesi qe ndryshojne e permiresojne punen ne shkolle dhe garantojne nje mbrojtje serioze, korrekte e ligjore ekonomike dhe sociale te sindikalisteve dhe te gjithe punonjesve te arsimit. Prandaj synimet dhe objektivat e vitit 2008 i kemi kushtezuar dhe i kushtojme me dialogun e vertete social, duke insistuar qe strukturat tona te ngrihen ne nivelin e ketij dialogu dhe partneret tane te tregojne angazhim, seriozitet e pergjegjesi ne marredhenie me sindikatat.

Edhe nje here gezuar festat e fundvitit!

Xhafer Dobrushi
Kryetar i FSASH

Bajram Kruja
Kryetar i SPASH

PERMBAJTJA

- *Editorial:* Dialogu social, objektivi yne kryesor per vitin 2008 2
- Tryeze e Rrumbullakte mbi angazhimin e sindikatave per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve 3
- Aktivitete te shumta dhe rezultative ne zbatim te Projektit me FNV / AOb. 9
- Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH 11
- Pergjigje te specialistit Fadil Kepi mbi ceshtje te vjetersise ne pune dhe pensioneve te mesuesve 12
- Baza sindikaliste mirepret takimet me drejtuesit qendror 13
- Mundesi arsimimi edhe per njerezit ne nevoje 13
- Te reja shkencore dhe keshilla praktike 15

Kopertina e pare:
Nga aktivitetet kulturore-artistike të zhvilluara në kuadrin e Projektit EI-NOT

Kopertina e fundit:
Nga punimet e Tryezës përmbyllëse të Projektit EI-NOT

TRIBUNA SINDIKALE
Nr. 31, Periodike
Botim i FSASH dhe SPASH
Me mbeshtetjen financiare te Konfederates se Sindikatave te Holandes, FNV
ADRESA PROVIZORE:
Pallati "TEKSTILISTI"
Lagja Kombinat, Tirane
Tel: + 355 68 20 34 674
+ 355 69 22 69 795
E-mail: fsash@icc-al.org
Internet: www.fsash-spash.com
Keshilli Botues:
Xhafer Dobrushi,
Bajram Kruja,
Lumturi Mataj,
Defrim Spahiu,
Petref Çelaj,
Aleks Dushi,
Stavri Liko, **Kryeredaktor**

TRYEZE E RRUMBULLAKET

MBI ANGAZHIMIN E SINDIKATAVE TE ARSIMIT PER RRITJEN E INTERESIT PER SHKOLLEN DHE ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

Ne vijim te angazhimit te tyre per rritjen e interesit per shkollen dhe eliminimin e punes se femijeve, dy sindikatat shqiptare te arsimit, Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, organizuan ne Tirane, Tryezen e Rrumbullakte, me pjesemarrjen e

Ne raportin qe mbajti ne emer te dy sindiktave te Arsimit, FSASH e SPASH, Kryetari i FSASH, zoti Xhafer Dobrushi, vuri ne dukje punen konkrete qe kane bere sindikatat, ne bashkepunim me Drejtorite e Shkollave ne dy shkollat e Bathores, per shmangien e largimeve nga shkolla te vajzave te klasave te larta te arsimit



perfaqesuesve sindikaliste, mesuesve, nxenesve e prinderve nga 6 shkolla te rrethev Tirane, (zona e Bathores), Elbasan dhe Korce, nje aktivitet ky permbylles i Projektit qe keto sindikata zbatuan gjate periudhes prill-dhjetor te ketij viti, me mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, dhe Fondacionit holandez, NOT.

Mermin pjese, gjithashtu, kryetaret e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, perfaqesues nga Ministria e Arsimit dhe Shkences, nga Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, nga ILO-IPEC ne Tirane, nga organizatat e punedhenesve etj.

9-vjecar; ne shkollat "De Rada dhe "Ptoleme Xhuvani" ne Elbasan per integrimin e nxenesve te komunitetit Rom ne shkolle e ne shoqeri dhe ne shkollat e minioritetit maqedonas ne Liqenas e Gorice te rrethit te Korces, per rritjen e interesimit per shkollen dhe kapercimin e disa veshtiresive qe ata hasin ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Mbi 50 mesues te ketyre shkollave moren ne kujdestari dhe punuan me mbi 130 nxenes, duke bere nje pune konkrete bazuar tek vecorite e secilit prej tyre, sipas te dhenave te pasqyruara ne pyetesoret e plotesuar qe ne fillim te zbatimit te ketij programi dhe duke perfshire ne kete pune edhe shoqe e shoke te klases se ketyre nxenesve, prinderit e tyre, perfaqesues te pushtetit vendore etj.

Frymezuese jane rezultatet konkrete te arritura, si rezultat i kesaj pune, duke u kthyer ne shkolle nje numer prej 18 femijesh, qe e kishin braktisur ate, duke dale nga rreziku i braktisjes se shkolles me shume se 32 nxenes te ketyre 6 shkollave, si edhe duke shenuar permiresime te dukeshme ne rezultatet ne mesime me shume se 24 prej tyre.

Drejtuesit e grupeve te punes ne nivel rrethi, Albina Pepo, Bukuroshe Shabani e Derall Tota, paraqiten punen e bere dhe rezultatetet e arritura ne shkollat e rretheve perkatese dhe parashtruan nje sere problemesh e detyrash per ta vazhduar kete pune ne te ardhmen.

Frymezuese ishin sidomos diskutimet e mesuesve Dilaver Lena, Nadire Taka, Albina Kolthi, Cvetko Male e te tjere, te angazhuar drejtperdrejt ne zbatimin e programit, te cilet kishin ardhur se bashku me disa nga nxenesit me te cilet ata kishin punuar dhe folen mbi punen e tyre, problemet qe kane hasur dhe eksperiencen e fituar ne kordinimin e kesaj pune edhe me partneret e tjere, si drejtorite e shkollave, organet e pushtetit vendor, komunitetin, prinderit dhe vete nxenesit.

Mesuesja Nadire Taka, duke e konsideruar si djalin e saj, nxenesin e komunitetit Rome, Erges Peqini, e falenderoi ate ne prani te pjese-marresve ne Tryeze, per reflektimin pas punes qe ajo beri me te e me familjen e tij per t'iu rikthyer shkolles, pasi e kishte braktisur ate, duke

Vijon në faqen 4

Vijon nga faqja 3

vazhduar normalisht shkollen dhe duke u integruar plotesisht ne klase se bashku me te gjithe nxenesit e tjere.

Drejtori i Mardhenieve te Punes ne Ministrine e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Bujar Cani, Perfaqesuesi i Ministrise se Arsimit, Fatmir Bezati, dhe Drejtuesja e Njesise per Eliminimin e Punes se Femijeve prane Ministrise se Punes, Shkelqesa Manaj, vleresuan angazhimin e sindikatave te arsimit dhe te mesuesve per kete ceshtje kaq te rendesishme te shoqerise sone, si edhe rezultatet e arritura, duke premtuar mbeshtetjen e institucioneve qe ata perfaqesojne per zgjerimin dhe thellimin e metejshem te kesaj pune ne te ardhmen.

Konkluzionet e nxjerra dhe plani i veprimit i miratuar ne kete Tryeze, sigurojne vazhdimin e kesaj pune ne shkollat pjesemarrese ne kete program dhe mundesine e zgjerimit te saj edhe ne shkolla te tjera te ketyre rretheve e me gjere.

TE RRISIM INTERESIN PER ARSIMIM CILESOR DHE ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

Fjala hyrese, mbajtur nga Z. Xhafer Dobrushi ne Tryezen permbyllese te Projektit, EI-NOT, pergatitur se bashku me Z. Bajram Kruja

Te nderuar pjesemarres te kesaj Tryeze,

Tashme eshte i njohur dhe i vleresuar angazhimi i dy sindikatave te arsimit ne Shqiperi, FSASH e SPASH, per trajnimin dhe sensibilizimin e drejtuesve dhe anetareve te tyre sindikaliste ne qarqe e rrethe, per t'u perfshire aktivisht dhe per te dhene ndihmen tone ne zgjidhjen e nje problemi kaq madhor per shoqerine shqiptare, sic eshte arsimimi cilesor i femijeve dhe eliminimi i punes se tyre. Ky angazhim vazhdon prej me shume se 5 vjetesh dhe do te vazhdoje deri sa ky problem te zgjidhet. Krahas disa projekteve dy vjecare ose me afat me te shkurter qe jane mundesuar me mbeshtetjen e Federates Nderkombetare te Sindikatave te Arsimit, EI, te Sindikates Holandeze te Arsimit, AOb, te Konfederates Holandeze te Sindikatave, FNV, te Programit Nderkombetar per Eliminimin e Punes se Femijeve, IPEC, etj, para 8-9 muajve, u inicua programi per rritjen e interesit te femijeve per shkollen dhe eliminimin e punes se tyre. Ky program u mbeshtet nga Federata Nderkombetare e Sindikatave, EI nepermjet Fondacionit Holandez NOT.

Vecorite e ketij programi, ne krahasim me programet e tjera qe cituam me lart jane dy:

Se pari, ndryshe nga programet e tjera qe deri tani jane zhvilluar ne nivel kombetar dhe deri ne nivel qarku ose rrethi, programi per te cilin do te diskutoje sot kjo Tryeze u fokusua drejt per drejte ne shkolle, pra ne nivel shkolle, me mesues, nxenes e prinder konkrete, atje ku problemi ekziston.

Se dyti, programi mbajti parasysh jo nxenesit ne pergjithesi qe braktisin shkollen, por disa kategori te vecanta me specifikat e tyre perkatese.

Ne pershtatje me keto vecori dhe kritere, ne konsultim me bazen tone sindikale, kryesite e SPASH dhe FSASH percaktuan 6 shkolla konkrete ne rrethet e Tiranes, Elbasanit dhe Korces, nga 2 shkolla per secilin rreth, ku do te zhvillohej ky program.

Kur flasim per vecori te nxenesve dhe shkollave qe u perzgjodhen kemi parasysh tre kategori nxenesish, nga radhet e te gjithe femijeve problematike:

1. Ne rrethin e Tiranes, u perqendruam ne dy shkollat 9-vjecare te Bathores, Bathore nr. 1 dhe 2. Ne keto shkolla vazhdojne arsimin e detyruar rreth 2750 nxenes, ndermjet te cileve ka shume prej tyre qe frekuentojne me nderprerje, qe braktisin fare shkollen dhe qe punojne ne forma e objekte te ndryshme te ndaluara per moshen e tyre. Por, me te gjithe keta femije ne kemi ndertuar nje program tjeter, ndersa ne kete rast zgjodhem nga te dy shkollat vetem 50 vajza nxenese, me te cilat u punua konkretisht per te shmangur rrezikun e braktisjes se shkolles si dhe kthimin ne shkolle ne rastet e largimeve prej saj gjate 2-3 viteve te fundit. Vecoria e ketij grupi eshte se keto nxenese nuk eshte se nuk e duan shkollen as se kane shkaqe kryesore vetem ekonomike, sic eshte varferia, per t'u larguar prej saj, por shkaqet jane, ne rradhe te pare, sinteze e nje opinioni te vjeter, frenues e shume te demshem per shoqerine, opinion qe mbartet nga zonat prej te cilave ato kane ardhe dhe qe i konsideron tashme te rritura, me nje fjale, sipas ketij mentaliteti, ato nuk e kane vendin ne shkolle, por duhet te mbyllen ne familje per t'u fejuar e martuar me vone. Dhe te mos harrojme se keto jane nxenese te klases se 7-te e te 8-te, por ne ndonje rast te vecante ka edhe nxenese te klases se 6-te. Kjo ndodh ne periferi te Tiranes me komunitete qe kane ardhur e jane vendosur ne Bathore per t'u integruar ne kryeqytet.

Nuk ka nevoje per shume argumente per te provuar se sa i rrezikshem eshte ky mentalitet dhe fenomeni qe ushqen ai, duke shkeputur

nga rruga e shkolles, nga shanset per t'u arsimuar, duke u hequr mundesine per progres ne jeten personale dhe njekohesisht per te kontribuar ne progresin e shoqerise, dhjetra e dhjetra vajzave.

2. Ne rrethin e Elbasanit, u perqendruam ne shkollat 9 –vjecare "De Rada" dhe " Ptoleme Xhuvani", ku mesojne rreth 1.250 nxenes, nje pjese e konsiderueshme e te cileve jane te komunitetit rom, por edhe egjiptian, te cilet perballen me veshtiresi te medha ekonomike qe kane familjet e tyre, por edhe me



qendrime te diferencuara, jo rralle edhe diskriminuese. Ne keto shkolla u perzgjodhen 40 nxenes te komunitetit rom, me te cilet eshte punuar nga mesuesit dhe shkolla, nga sindikatat, ne menyre konkrete per t'i ndihmuar ata qe t'i kapercejne keto veshtiresi dhe te integrohen sa me mire ne klasat ku mesojne, ne mjediset e shkolles dhe ne shoqeri.

3. Ne rrethin e Korces, u perzgjodhen 2 shkollat e Komunes se Liqenasit, ku banon komuniteti maqedonas dhe natyrisht nxenesit jane nga ky komunitet. Ne keto 2 shkolla nuk ekziston fenomeni i braktisjes dhe pothuaj as tendeca per te brakstisur shkollen. Ketu veshtiresite dhe problemet jane te nje natyre tjeter, por qe sjellin si pasoje uljen e nivelit te pervetesimit te mesimeve, cenimin e cilesise. Ne keto 2 shkolla mesojne 340 nxenes. Ne konsultim me keshillat sindikale, me mesuesit dhe drejtorite e shkollave u perzgjodhen 40 nxenes, te cilet kane relativisht rezultate te dobeta, nje zbehje te interesimit per shkollen, qe vjen nga veshtiresite ekonomike qe perballojne familjet e tyre, por edhe nga veshtiresi qe vijne per shkak te cilesise jo te mire ose te mungeses se teksteve ne gjuhen ametare, te programeve mesimore, etj.

Ne kuadrin e ketij programi u mundesua qe te punohet me 130 nxenes te te tre kategorive qe permendem dhe u angazhuan ne punen me ta rreth 50 mesues. Synimi ishte qe ky kontigjent nxenesish te ndihmohet per t'i nxjerre nga kjo gjendje dhe per t'i integruar ne menyre aktive ne klasat dhe shkollat ku mesojne si dhe ne shoqeri.

Programi u ndertua dhe u zhvillua ne disa faza. Fillimisht u percaktuan masat organizative. U ngrit nje komitet ne nivel qendror me pjesemarrjen e drejtuesve te te dy sindikatave, te perfaqesuesve te Ministrise se Arsimit dhe Shkences dhe te Drejtorive Arsimore Rajonale perkatese. Komiteti perpunoi nje plan te hollesishem masash per secilin rreth dhe per te gjitha fazat e zhvillimit te programit.

Me rendesi ishte ngritja e grupeve ne shkalle rrethi per te dy shkollat. Ne grupet e rretheve filloi faza e konkretizimit, duke analizuar gjendjen ne secilen shkolle. U percaktuan mesuesit qe treguan gatishmeri per te punuar dhe nxenesit emer per emer, me te cilet do te punonte cdo mesues. Ne kete faze u be nje pune pergatitore per te njohur mesuesit me kuadrin institucional qe trajton punen e femijeve dhe per te rritur sensibilizimin e opinionit te te gjithe mesuesve te shkolles per t'u perballur me problemin.

Ne fazen e dyte u hartua nje pyetsor, i cili u plotesua nga te gjithe nxenesit e perfshire ne program. Plotesimi i pyetsoreve, pergjigjet e simperta dhe pergjithesisht te sakta te nxensve u bene nje ndihme e madhe per sindikatat, drejtorite e shkollave dhe vete mesuesit per te zbuluar me mire dhe saktesuar shkaqet qe i cojne keta nxenes ne rrugen e ndarjes me shkollen. Mbi kete baze, ne secilen shkolle, me nje mase te madhe mesuesish, me nxenes dhe prinder u organizua diskutimi per keto shkaqe dhe u percaktuan masa per menjanimin e tyre.

Faza e trete ishte nga me interesantet. Ajo u konceptua dhe u zhvillua si nje kompleks veprimtarish kulturore, artistike dhe sportive ne formen e garave midis nxenesve te te dy shkollave te secilit rreth. Veprimtarite sportive me lojera futbolli, volejbolli, basketbolli etj, veprimtarite muzikore me kenge e valle, vizatimet dhe recitimet terhoqen vemendjen e pothuaj te gjithe nxenesve te ketyre shkollave. Ne Bathore, p.sh., ne projekt ishte parashikuar qe ne keto veprimtari te merrnin pjese 50 nxeneset me probleme dhe 15 apo 16 mesuesit qe punonin e kujdesin per to.

Vijon në faqen 6

Vijon nga faqja 5

Por nuk ndodhi keshtu. Oret e aktiviteteve kulturore, artistike e sportive u kthyen ne nje feste ne shkolle. Ne keto aktivitete moren pjese mbi 250 nxenes dhe rreth 40 mesues. Keshtu ndodhi edhe ne dy shkollat e Elbasanit dhe ne ato te Liqenasit te Korces. Ne keto veprimtari luanin e konkuronin bashke, pa asnje dallim, nxenesit e rregullt dhe me rezultate te larta ne mesime si dhe shoket e tyre qe, per nje shkak apo nje tjeter, kishin filluar te largoheshin nga shkolla ose ta braktisnin ate.

Aktivitetet kulturore, artistike e sportive paten jehone midis nxenesve, por edhe mesuesve per nje kohe te gjate. Dhuratat modeste qe Sindikatat Qendrore te Arsimit u bene ketyre shkollave, sic ishin topa futbolli, volejbolli, basketbolli, rrjeta etj, u vleresuan si nje mundesi per vazhdimesine e veprimtarive sportive, aq te nevojshme per t'i miqesuar femijet, per te sfiduar individualizmin dhe indiferentizmin dhe per te kultivuar e rrenjosur ndjenjen e solidaritetit midis femijeve, ate te rritjes se interesit per fatet e shokut te klases apo te shkolles, etj.

Nje moment i rendesishem i gjithe ketij programi ishte anketimi. Plotesimi nga vete nxenesit i pyetsorit qe per gatiti komiteti ne nivel qendror, zbuloi shume shkaqe qe ndikonin dhe ndikojne ne zbehjen e interesit dhe te deshires se shume femijeve per shkollen, deri ne ate mase sa shume prej tyre e braktisnin ose e braktisin fare ate.

Pergjigjet e sinqerta te nxenesve qe u anketuan per pyetjet se cilat jane marredheniet e tyre me shkollen dhe me mesimet, se cila ose cilat lende u pelqejne me shume, a gjeni mbeshtje kur ndodheni para veshtiresive dhe nga kush, nga mesueset apo nga shoket e klases, se a keni mesues apo mesuese qe u besoni dhe u shfaqni shqetsimet dhe problemet tuaja, nese po cilet jane keta, si e ndjeni veten ne komunitetin e klases, si i keni marredheniet me nxenesit e komuniteteve te tjera, a keni enderrime dhe synime ne jete dhe cilat jane ato dhe se fundi se a mendoni e besoni se ka zgjidhje per ta ndryshuar gjendjen ne te cilen ndodheni; zbulojne nje bote te tere te brendshme te ketyre femijeve, bote e kushtezuar nga veshtiresi te shumeta ekonomike, familjare, shoqerore, komunitare, por e ndikuar e kushtezuar jo pak edhe nga cilesia e sherbimeve qe ofron shkolla, nga niveli shkencor pedagogjik dhe morali i shume mesuesve, nga mungesa e theksuar e respektit dhe dashurise prinderore qe manifestojne ata ndaj nxenesve. Ne cdo shkolle, nga 1 deri ne 4 nxenes te anketuar jane pergjigjur se nuk i besojne asnje mesuesi dhe pjesa dermuese e te anketuarve pergjigjen se i besojne vetem 1 ose ne raste te rralla 2 mesuesve, megjithese neper klasat qe ata kane kaluar kane pase kontakte mesimdhenjeje me dhjetra mesues. Nuk jane te pakte nxenesit qe pergjigjen se kur kane nevoje per ndihme te diferencuar ne mesime, kete ndihme nuk e gjejne tek mesuesi ose mesuesit e tyre.

Kjo zbulon dobesi e mangesi te theksuara te procesit mesimor edukativ ne shkolle, indiferentizem dhe mungese aftesish nga jo pak mesues ose mesuese. Duhet te thuhet hapur dhe me force se me kete qendrim dhe paaftesi te tyre, keta tipa, qe titullin mesues e mbajne ne paranteze, ne thonjza, dashur pa dashur, behen shkaktare dhe kane nje pjese te pergjegjesise per fenomenin e uljes se interesit e te deshires se shume nxenesve per shkollen, per mungesat ne oret e ketyre mesuesve, deri edhe per braktisjen e shkolles.

Sindiktatat e Arsimit, keshillat sindikale ne shkolla kane arme te forta per ta luftuar kete te keqe. Ato kane ne radhet e tyre me dhjetra e dhjetra mesues shembullore, qe jane per nxenesit ne kuptimin e vertete te fjales nje prind i dyte, qe me aftesite e tyre profesionale, me shembullin dhe figuren e tyre, i afrojne femijte, jetojne me problemet dhe shqetsimet e tyre. Jane pikerisht keta mesues, nje pjese te te cileve i kemi sot midis nesh, qe jane perfshire vullnetarisht, deri tani pa asnje shperblim, ne punen fisnike per rritjen e interesit te femijeve per shkollen dhe eliminimin e punes se tyre. Ky shembull i shumices eshte i mjaftueshem per te shkundur koleget e tyre indiferente, per t'i terhequr ata ne kete aksion te madh dhe per te diferencuar te pandreqshmit. Kjo eshte nje fushe ku duhet te bashkeveprojne ne menyre te suksesshme, si partnere te vertete drejtuesit e arsimit te cdo niveli dhe sindikatat.

Pothuaj te gjithe nxenesit e anketuar jane pergjigjur se kane deshire te vazhdojne shkollen, por jane prekese e te dhimbeshme arsyet qe pershkruajne ata, aresye qe i detyrojne te largohen prej saj, sidhmos te varferia dhe mungesa e prinderve. Ne keto raste vete ata propozojne zgjidhje, kerkojne ndihme, ndihmen e kerkojne nga mesuesit, nga sindikatat e mesuesve, nga shkolla dhe nga organet e pushtetit vendor dhe nuk ka asnje dyshim se kjo ndihme u duhet dhene atyre, permdryshe parullat per te drejtat e njeriut, per te drejtat e femijeve, per shanse te barabarta mbeten vetem slogane.

Anketat perbejne nje objekt studimi me te thelluar nga Sindikatat Qendrore, nga organet drejtuese te arsimit dhe vecanrisht nga pushteti vendor. Te gjithe kerkesat qe preokupojne kete kategori nenesish jane te zgjidhshme.

Dhe ja, te nderuar pjesemarres, pas ketyre fazave qe shkurtimisht i parashtruam ne kete fjale hyrese dhe qe zgjaten me shume se 8 muaj ne keto 6 shkolla, sot jemi mbledhur ne kete tryeze te gjithe bashke, mesues

sindikaliste, drejtues shkollash dhe te Drejtorive Arsimore Rajonale, nxenes dhe prinder, perfaqesues te punedhenesve, per te pare se cfare beme, cfare arritem dhe c'duhet te bejme me tej.

Ajo qe mund te themi qe ne fillim eshte se puna qe beme te gjithe se bashku ka dhene rezultatet e para. Konkretisht:

- Ne dy shkollat e Bathores nga 29 vajza qe kishin braktisur shkollen nga klasa e 6-te ose e 7-te para nje deri 3 vjetesh, u kthyen ne shkolle 9 prej tyre, te cilat tani frekuentojne rregullisht dhe jane te vendosura te mbarojne arsimin e detyruar 9 vjecar.



Po keshtu, ne kete vit shkollor frekuentojne rregullisht edhe 21 vajza te tjera qe frekuentonin me hope dhe ishin ne rrezik per t'u larguar nga shkolla.

- Ne Elbasan, ne Shkollen " Ptoleme Xhuvani" nga 25 nxenes te komunitetit rom qe ishin perfshire ne projekt dhe qe perbenin rrezik per ta braktisur shkollen, 7 prej tyre kane dale plotesisht nga kjo gjendje dhe frekuentojne rregullisht dhe kane rezultate inkurajuese ne mesime. Ndersa ne Shkollen " De Rada" nga 20 nxenes qe u perfshine ne projekt, 4 prej tyre kane dale nga rreziku i braktisjes. Po keshtu, ne keto dy shkolla 9 nxenes qe pothuaj e kishin braktisur shkollen, tani jane kthyer dhe frekuentojne rregullisht.

- Ne Shkollat e Liqenasit dhe te Gorices 24 nxenes, nga 40 qe u aktivizuan ne projekt, kane dale nga gjendja dhe niveli i rezultateve minimale dhe tregojne nje interesim me te madh per nje nivel me te larte te pervetesimit te dijeve. Gjate projektit keto dy shkolla u ndihmuan ne menyre konkrete per te vene ne rrugen e zgjidhjes disa probleme qe ndikonin drejt per drejt ne nivelin e pervetesimit te mesimeve, sic jane permiresimi dhe botimi i teksteve ne gjuhen amtare, tekstet per lendet e tjera, interesimi per transportin e mesuesve dhe te nxenesve etj. Ketyre shqetsimeve u eshte celur rruga e zgjidhjes qe nga Ministria e Arsimit dhe tani nuk ka me pengesa per to.

Keto jane ne menyre fare te permbledhur disa nga arritjet me the lbesore qe ne mundem te realizojme gjate ketyre 8-9 muajve ne keto 6 shkolla. Por rritja e interesit per shkollen dhe eliminimi i punes se femijeve nuk eshte nje fenomen qe zgjidhet per disa muaj. Faktoret qe e ushqejne kete fenomen, sic e pame, jane te shumte dhe puna per uljen dhe eliminimin e ketij fenomeni perben nje proces, nje proces te gjate, qe kerkon forca, mjete dhe angazhim te vazhdueshem.

Kjo do te thote se ne, sindikatat e arsimit, jemi te vendosura qe te mos heqim dore nga puna e nisur. Ne nuk do t'i leme punen dhe perpjekjet tona ne mes te rruges, nuk do te mjaftohemi me ato rezultate qe arritem, sepse nese nuk vazhdojme te ecim perpara do te rrezikojme e izolojme edhe arritjet e derisotme.

Kjo do te thote, gjithashtu, se ne, Sindikatat, do te vazhdojme te bashkepunojme e bashkeveprojme me punedhenesin, me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, me Drejtorite Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore, me drejtorite e shkollave, duke kerkuar dhe dhene llogari para njeri-tjetrit, per rezultate te tjera me te larta dhe me te qendrueshme deri ne eliminimin e punes se femijeve dhe te shkaqeve qe ndikojne ne uljen e interesit per shkollen.

Ne, sindikatat e arsimit, ashtu sic eshte sanksionuar edhe ne Kontraten Kolektive te Punes te nivelit te pare, se bashku me punedhenesin, me MASH dhe Drejtorite e Zyrat Arsimore, do te paraqitemi si nje pale e vetme per keto probleme para organeve te pushtetit vendor per te ndikuar dhe zgjidhur ato ceshtje qe varen nga keto organe, sic jane zbutja e varferise, rritja e punesimit, perdorimi me kritere te drejta te ndihmes ekonomike, etj.

Se fundi, ne do te bashkerendojme punen tone me organizatat joqeveritare, me institucionet e vendit dhe ato te huaja, qe jane te angazhuara per nje arsim cilesor publik, per shanse te barabarta, per mbrojtjen e te drejtave te femijeve dhe eliminimin e punes se tyre.

Vijon në faqen 8

Vijon nga faqja 7

P R O G R A M
Per
VAZHDIMESINE E ANGAZHIMITTE SINDIKATAVE TE ARSIMIT PER RRITJEN E INTERESIT PER SHKOLLEN DHE ELIMINIMIN E PUNES SE FEMIJEVE

1. Federata e Sindikatave te Arsimit dhe Shkences, FSASH, dhe Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, shprehin vendosmerine e tyre qe, ne kuadrin e angazhimit te pergjithshem per zbutjen dhe eliminimin e punes se femijeve dhe uljen e numurit te nxenesve te arsimit te detyruar qe braktisin shkollen ose frekuentojne me nderprerje, te vazhdojne me tej punen e nisur ne 6 shkollat e rretheve Tirane, Elbasan dhe Korce, me synimin per te rritur interesin per shkollen dhe per te eliminuar punen e nxenesve.

2. Angazhimi i perbashket i SPASH dhe FSASH per vazhdimesine e projektit per rritjen e interesit per shkollen do te mbeshtetet edhe nga partneret dhe grupet e tjera te interesit, perfshire Ministrine e Arsimit dhe Shkences, Ministrine e Punes, Ceshtjeve Social dhe Shanseve te Barabarta, Drejtorite Arsimore Rajonale te Qarqeve Tirane, Elbasan dhe Korce, Organizatat e Punedhenesve, te drejtorite e shkollave perkatese dhe seksionet sindikale te te dy sindikatave ne keto rajone.

3. Pjesemarresit ne Tryeze, duke marre ne konsiderate punen e bere ne periudhen prill – dhjetor 2007, te zhvilluar ne disa etapa dhe rezultatet e arritura, qe u evidentuan nga mesuesit, drejtuesit e shkollave, prinderit dhe vete nxenesit, vleresojne si arritje te kesaj faze:

- Ngritjen ne secilen shkolle te strukturave qe merren me nxitjen e interesit per shkollen, me motivimin e nxenesve per rezultate me te larta ne mesime dhe per eliminimin e punes se femijeve.

-Angazhimin vullnetar te nje numuri gjithnje e me madh mesuesish nga secila shkolle dhe evidentimin e marrjen ne kujdestari prej tyre te nxenesve me problematike, duke punuar me ta dhe familjet e tyre dhe duke mundesuar qe shume nga keta nxenes te kthehen e integrohen ne shkolle dhe te frekuentojne rregullisht.

4. Ruajtja e ketyre strukturave, si dhe forcimi e konsolidimi i tyre, duke ruajtur kompozimin ekzistues me drejtues sindikaliste, drejtues te arsimit ne rajone e shkolla, mesues, prinder e nxenes dhe perfaqesues te pushtetit vendor, perben kushtin kryesor qe puna e nisur te mos mbetet ne gjysem te rruges dhe rezultatet modeste qe jane arritur te fuqizohen per te arritur synimin final.

5. Objekt i vemendjes dhe punes se ketyre strukturave dhe sidomos i grupeve te punes ne shkolla, do te jete evidentimi i shkaqeve qe kane cuar dhe cojne ne uljen e interesit te nxenesve per shkollen, per arsimimin e tyre, ne frekuentimin me hope ose braktisjen e shkolles dhe perfshirjen ne pune te rrezikshme dhe te ndaluara per moshen e tyre. Ne baze te anketave dhe te pergjigjeve qe kane dhene vete nxenesit, grupet e punes dhe mesuesit qe punojne drejt per drejt me nxenesit problematike duhet t'i vleresojne dhe klasifikojne keta faktore, per t'u perqendruar ne eliminimin e atyre faktoreve qe ndikojne me shume ne kete fenomen.

6. Ne nje faze te dyte te ketij projekti qe duhet te shtrihet gjate gjithe vitit 2008, duhet te mbahen parasysh ne menyre te vecante:

-Trajnimi i metejshem i mesuesve qe u angazhuan ne fazen e pare dhe qe punuan me nxenes konkrete.

-Mbajtja ne vezhgim nga secili mesues i angazhuar i kontigjentit te nxenesve me te ciliet punoi ne fazen e pare, ndertimi i nje pune te vecante me secilin dhe ndihma qe u duhet dhene atyre per te eliminuar ata faktore qe kane ndikuar e ndikojne ne zbehjen ose humbjen e interesit te tyre per shkollen.

-Klasifikimi i grupit te nxenesve me te cilet punon nje mesues, duke ndertuar nje pune te vecante me ata qe jane permiresuar dhe nje program e pune tjeter me ata qe mbeten akoma problematike.

- Zgjerimi i rrethit te mesuesve vullnetare qe punojne me kete kategori nxenesish dhe perfshirja e te gjithe nxenesve problematike qe ka shkolla, nese ka te tille qe ne fazen e pare nuk jane perfshire ne vemendjen apo kujdestarine e mesuesve.

SPASH dhe FSASH do te bashkepunojne nga afer me MASH, Drejtorite Rajonale dhe Drejtorite e Shkollave, per te eliminuar mangesite qe ekzistojne sot ne keto shkolla dhe qe lidhen me plotesimin me mire te bazes materiale per aktivitete te vazhdueshme e cilesore sportive, muzikore e artistike. Nga anketimi i bere dhe nga aktivitetet e zhvilluara ne terren shihet qarte se keto veprimtari dhe keto lende i terheqin shume, sidomos kete kategori nxenesish dhe ndikojne ne rritjen e interesit te tyre per shkollen, duke i integruar ata me mire ne komunitetin e nxenesve.

7. Sindiktat Qendrore, ne bashkepunim me Ministrine e Arsimit dhe Shkences, te gjejne e percaktojne mundesi dhe forma per te motivuar mesuesit qe vullnetarisht jane perfshire ne punen edukuese me nxenesit gjate dhe jashte procesit mesimor dhe i ndihmojne ata per t'u integruar me mire ne shkolle dhe per te braktisur jo shkollen por format e keqia dhe te rrezikshme te punes se tyre.

8. Drejtuesit e arsimit ne rajon dhe ne shkolla, por edhe mesuesit duhet te nxjerrin konkluzione nga preferencat qe kane shprehur nxenesit ne anketimin e bere per lende te vecanta dhe per mesues te vecante. Kjo lidhet drejt per drejt me rritjen e kerkeses ndaj secilit mesues per kualifikim profesional, per te mundesuar cilesi te larte ne arsimimin qe afron shkolla publike.

9. Synimi afatgjate i ketij programi te jete qe 6 shkollat e pilotuara dhe te perfshira ne kete nisme, te arrijne qe te mos kene asnje nxenes braktises ose qe punon, qe te gjithe nxenesit qe regjistrohen ne klasen e pare te mbarojne arsimin 9-vjecar te detyruar.

AKTIVITETE TE SHUMTA DHE REZULTATIVE NE ZBATIM TE PROJEKTIT ME FNV-AOb

Tani qe kane kaluar afer tete muaj nga puna per zbatimin e Projektit me FNV-AOb, "Konsolidimi i metejshem i sindikatave shqiptare te arsimit dhe rritja e kapaciteteve te tyre per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve", pa hezitim mund te thuhet se ndikimi i tij ne arritjen e objektivave dhe rezultatave ne keto drejtime eshte i dukshem.

Keto arritje jane, gjithashtu, rrjedhoje e nje vleresimi serioz te te gjithe punes organizative parapergatitore dhe i bashkepunimit gjithnje e me te mire midis dy sindikatave tona te arsimit, FSASH e SPASH, dhe sindikatave holaneze FNV e AOb.

1. Konsolidimi i seksioneve sindikale:

Aktivitetet me kete synim bazohen ne zbatim te Programit te Punes per periudhen maj 2007-prill 2008, dhe filluan me mbledhjen e Grupit te Punes, ne nivel kombetar, ku u percaktuan edhe detyrat kryesore dhe afatet. Me pas u ndermore nje pune konkrete, sidomos ne 10 rrethet e mbetura nga faza e pare, te cilat jane: Bulqiza, Delvina, Gramshi, Hasi, Puka, Saranda, Tropoja, Peqini, Gramshi, Saranda. Nje takim i posacem u organizua me drejtues te ketyre rretheve, ku u analizua situata dhe u percaktun drejtimet kryesore te punes, sidomos ne drejtim te riorganizimit te strukturave dhe rritjes se numrit te anetareve qe paguajne rregullisht kuoten e anetaresise. Me pas, u organizua seminari per trajnimin e ketyre te zgjedhurve, ku u referuan tema, u bene diskutime dhe u perpunua nje program veprimi, i cili eshte duke u ndjekur per zbatim pothuajse ne te gjitha keto seksione.

Te dy kryetaret e e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushi e Bajram Kruja, prezent ne seminar, shprehen mendimet e tyre ne lidhje me tematiken e seminarit dhe problemet e konkrete te ngritura nga pjesemarresit, sidomos ne lidhje me qendrimet e padrejta te disa drejtorive arsimore ndaj mesuesve te diplomuar ne shkollat e mesme pedagogjike.

Vemendje e vecante i eshte kushtuar shtimit te te ardhurave nga kuotat e anetaresise, duke insistuar prane ketyre seksioneve se anetare konsiderohen vetem ata mesues qe angazhohen ne sindikate dhe paguajne kuoten e anetaresise. Per kete qellim theksi eshte vene ne zbatimin e metodes bashkekohore te grumbullimit te kuotes nepermjet zbritjes nga paga dhe kalimit direkt ne numrin e llogarise te seciles prej dy sindikatave, gje qe kerkon kontakte dhe mardhenie bashkepunimi edhe me autoritetet lokale, sidomos me perfaqesuesit e bashkive e komunave dhe zyrave perkatese te financave ne keto njesi.

Si rezultat i punes se bere, SPASH ka tani nje rritje prej me shume se 1 000 anetare, ndersa FSASH nje numer prej afersisht 250 anetare.

Natyrisht muajet ne vijim jane vendimtare per arritjen e objektivave me te larta qe jane percaktuar ne kuadrin e ketij Projekti.

2. Pjesemarrja e grave ne sindikate:

E njejta metode po ndiqet edhe per rritjen e numrit te grave mesuese ne sindikate. Pas mbledhjes se grupit te punes ne nivel kombetar, perfaqesueset e komiteteve te



grave ne keto 10 rrethe kane punar konkretisht per rritjen e numrit te grave ne sindikatat perkatese dhe per nje trajtim me te mire te problemeve te tyre ne sindikate.

Nje ndikim te drejtperdrejte ne punen e tyre ka patur pjesemarrja ne seminarin treditor te organizuar ne Tirane, ku mori pjese edhe lektorja holandeze Claire Oostvriesland, e cila beri shume soparime ne lidhje me aktivizimin e grave ne sindikate dhe paraqiti pervojen e sindikates se arsimit te holandes AOb, ne lidhje me kete ceshtje.

Ne seminar u perpunua edhe nje program veprimi, i cili parashikon:

-Organizimin e trajnimeve te tilla modeste edhe ne rrethet perkatese nga pjesemarreset ne seminar me grate mesuese aktive ne sindikate,

- Nje pune me konkrete per trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve te grave mesuese, me qellim qe ato ta kuptojne rendesine e sindikaates dhe te organizohen ne radhet e saj,

- Insistimin ne nivel qendror sidomos, per permiresimin e legjislacionit ne lidhje me statusin e grave mesuese,

- Perpunimin e problemeve kryesore qe do te jene objekt i seminareve te nivelit me te larte qe jane parashikuar te zhvillohen ne vijim, ne kuader te ketij projekti.

Nje pune konkrete ka filluar, gjithashtu, per te nxitur me tej aktivizimin e komiteteve te grave ne rrethet qe tashme mund te konsiderohen te konsoliduara, ku po organizohet nje anketim, mbi bazen e nje pyetsori. Me shume se 650 gra sindikaliste, ne 65 shkolla te 26 rretheve, po kontaktohen nepermjet ketij pyetsori, per te mjchur me mire gjendjen dhe per te nxjerre konkluzione mbi punen e bere deri tani dhe masat qe duhen te merren per permiresimin e kesaj pune ne te ardhmen. Tryeza e rrumbullakte e parashkuar qe te zhvillohet ne fillim te vitit te ardhshem, ne lidhje me konkluzionet e ketij anketimi, ku pritet qe te marrin pjese edhe eksperte nga AOb Holande, do te shenoje nje moment shume te rendesishem per punen me grate sindikaliste ne dy sindikatat tona te arsimit.

Vijon në faqen 10

Vijon nga faqja 9

Drejtueset e komiteteve te grave te te dyja sindikatave ne nivel qendror, duke marre pjese ne kete seminar edhe si lektore, njohen nga afer situaten e strukturave te grave, problemet e kerkesat e tyre dhe e kane me te lehte punen per t'i mbeshtetur ato ne realizimin e objektivave te caktuara dhe te aktiviteteve, sipas planit te veprimit te perpunuar dhe miratuar ne kete seminar.

3 Angazhim konkret per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve:

Kjo perudhe ka qene e mbushur me aktivitete te shumta ne lidhje me parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve, si ngritja dhe funksionimi permanent i me shume se 24 grupeve te punes ne baze rrethi e shkolle, marrja ne kujdestari e me shume se 500 nxenesve dhe puna konkrete me ta per t'i nxjerre nga rreziku i braktisjes se shkolles dhe puna ne rruge, organizimi i seminarit me pjesemarrjen e mesuesve prinderve e nxenesve nga dy prej rretheve ku FSASH e SPASH jane fukusuar, Tirana e Kroca, si edhe konsultimet dhe aktivitetet e tjera ne bashkepunim edhe me aktore te tjere qe veprojne ne fushen e mbrojtjes se femijeve dhe eliminimit te punes se tyre.

Ne seminarin e organizuar ne Tirane, me pjesemarrjen edhe te perfaqesuesve te prinderve e nxenesve, u gershetuan mire spjegimet teorike ne lidhje me standardet nderkombetare mbi punen e femijeve me diksutimet konkrete te situates, te punes se bere, rezutateve te arritura dhe detyrat qe shtrohen perpara mesuevse, prinderve e vete nxenesve per eliminimin e braktisjes se shkolles dhe te punes se femijeve.

Me shume interes u ndoqen spjegimet e drejtueses se njesise per eliminimin e punes se femijeve, qe vepron ne kuadrin e Ministrise se Punes, Zj. Shkleqesa Manaj, ne lidhje me Paketen "SCREAM" dhe Manualin mbi Arsimin Jo Formal, dy botime keto shume te rendesishme te sindkatave te arsimit, ne bashkepunim me Zyren e ILO-IPEC ne Tirane.

Akoma me konkrete e terheqese ishte seanca e zhvilluar ne Bathore, ku mesues, prinder e nxenes folen per punen e bere dhe treguan per eksperiencen e tyre disa vjecare ne punen me nxenesit me probleme ne vijim dhe ne pervetesimin e lendeve mesimore.

Vemendje e vecante i eshte kushtuar angazhimit te sindikatave te degeve te tjera ne aktivitetet per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve. Pas disa kontakteve e konsultimeve me perfaqesues te dy konfederatave, KSSH e BSPSH, dy sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, organizuan nje workshop me pjesemarrjen e drejtuesve kryesore te sindikatave te tekstilit, veshjeve dhe prodhimit te kepucave; te industrise se lehte; bujqesise; tregtise; shendetesise, si edhe perfaqesues te keshillave sindikale te KSSH e BSPSH nga rrethet Tirane, Fier, Elbasan etj.

Diskutimet ne kete workshop u bene mbi bazen e nje dokumentacioni te pasur, perfshire materiale qe kishin te benin me soparimet pse puna e femijeve eshte nje ceshtje sindikale, cilat jane fushat ku mund te nderhyjne sindikatat per eliminimin e saj, konkluzionet e Konferences Kombetare te zhvilluar per kete ceshtje ne tetor 2004, sugjerimet e Konferences Rajonale, te zhvilluar ne tetor 2006, si edhe Rezoluten e Kongresit te Trete te KSSH mbi angazhimin e sindikatave per eliminimin e punes se femijeve.

Pas nje prezantimi te shkurter mbi situaten aktuale ne lidhje me punen e femijeve ne Shqiperi dhe nevojen per nje angazhim te te gjitha sindikatave per shmangien e ketij fenomeni, paraqitur nga Zj. Shkelqesa Manaj, zoti Xhafer Dobrushi prezantoi situaten dhe permiresimet e nevojshme ne lidhje me kordinimin e punes midis sindikatave te arsimit dhe atyre te degeve te tjera, per nje veprimtari te suksesshme per parandalimin dhe eliminimin e punes se femijeve.

Duke marre pjese aktive ne diskutime, drejtuesit e sindikatave, si Minella Mano, Hajdar Kanani, Petrit Dajko, Alfred Xhomo, Tafil Gjolena, Luan Zonja etj, informuan per punen e bere dhe problemet qe dalin, duke bere edhe propozime konkrete per nje program veprimi per te ardhmen.

Dy drejtuesit e sindikatave te arsimit, Xhafer Dobrushi dhe Bajram Kruja, bene konkluzionet e seminarit dhe parashtruan disa nga drejtimet kryesore te punes se ketyre sindikatave ne kuadrin e zbatimit te keij Projekti.

Te gjitha propozimet e sugjerimet e ketij workshopi jane duke u perpunuar ne bashkepunim me drejtuesit e sindikateve te tjera duke synuar disa rezultate konkrete deri nga pranvera te vitit te arshem, kur do te mblidhet perseri nje Tryeze e Rrumbullakte, me pjesemarrjen edhe te disa aktoreve te tjere te angazhuar ne kete ceshtje, per te diskutuar ne lidhje me ecurine e kesaj pune dhe detyrat per me tej.

4. Komunikimi me anetaret:

Eshte nje nga drejtimet ku vihen re, gjithashtu, permiresime te dukeshme, si nepermjet takimeve, kontakteve, mbledhjeve, seminareve, ashtu edhe nepermjet Revites "Tribuna Sindikale", e cila vazhdon te botohet rregullisht, si edhe nepermjet faqes zyrtare te internetit, e cila eshte nje permbledhje shume serioze per te gjithe ata drejtues sindikaliste, mesues, anetare ose jo te sindikatve qe duan te njohin nga afer gjithe aktivitetin e tyre dhe te marrin pjese gjallerisht ne perpunimin e politikave sindikale dhe organizimin e aktiviteteve te ndryshme ne shkollat dhe seksionet perkatese.

Botimi dhe ribotimi i Kontrates Kolektive te Punes ne Reviste dhe vendosja e saj ne faqen e internetit e kane lehtesuar se tepermi mundesine e cdo mesuesi per t'u njohur me sherbimet qe sindikatat u ofrojne anetarve dhe per te kerkuar permiresimin e metejshem te ketyre sherbimeve.

Per nje komunikim sa me te mire edhe me partneret nderkombetare dhe organizatat simotra, nje varint me i shurtuar i kesaj faqeje ne intrenet eshte edhe ne anglisht, gje qe eshte vleresuar pothuajse nga te gjithe partneret tane.

5. Puna pergatitore per aktivitetet e ardheshme:

Shume aktivitete jane parshikuar te zhvillohen ne kuadrin e ketij projekti ne muajet e arshem, duke filluar nga seminaret per eliminimin e punes se femijeve ne Fier e Korce, Tryezat e rrumbullakta per pjesemarrjen dhe rolin e grave mesuese ne sindikate, per sherbimet ndaj anetarve per perfshirjen e sindikatave te tjera ne aktivitetetper eliminimin e punes se femijeve, etj, per te cilat kryesite qendrore te FSASH e SPASH po marrin masa te gjithanshme organizative per t'i shoperuar keto aktivitete me rezultate konkrete ne fuqizimin e strukturave te tyre, rritjen e rolit te tyre ne tere procesin mesimor edukativ dhe eliminimin e punes se femijeve.

Dy sindkatat tona te arsimit u jane shume mirenjohese sindiktavae holandeze FNV e Aob per solidaritetin, mbeshtetjen dhe ndihmen financiare e teknike qe vazhdojne te japin per realizimin e ketyre objektivave te guximeshme qe FSASH e SPASH kane percaktuar per me shume sherbime ndaj anetareve, per mbrojtjen e femijeve dhe per zhvillimet progresive te sistemit arsimor ne vendin.

Stavri LIKO
Kordinator i Projektit

Nga mbledhja e Keshillit Kombetar te SPASH

Me 7 dhjetor 2007 u mblodh Keshilli Kombetar i SPASH, i cili analizoi punen e bere gjate vitit 2007 dhe percaktoi objektivat per vitin e ardhshem. Projeke veprimtaria per vitin 2008. Keshilli diskutoi, gjithashtu, mbi disa ceshtje te ndryshme qe kishin te benin sidomos me solidaritetin dhe ndihmat nepermjet projekteve per ambjente pune ne nivel qendror e lokal, nevoja dhe pergjegjesia e hapjes se niptit nga qendra dhe rrethet, nevoja e perfaqesimit edhe me anetare kryesie ne aktivitetet kombetare, njohja me ceshtjen e Urdherit te Mesuesit etj.-

Kryetari i SPASH, z. Bajram Kruja, ne fjalen hyrese, u ndal posacerisht ne analizen e punes se bere, rezultateve te arritura, problemeve qe kane dale gjate vitit 2007 dhe parashtroi disa nga drejtimet kryesore te punes per vitin 2008.

Ai theksoi se veprimtaria e aprovuar ne shkurte te ketij viti per Keshillin Kombetar dhe Komitetin Drejtues jane realizuar ne menyre te kenaqeshme. Kontrata kolektive e nivelit te pare eshte bere e njohur dhe jane paisur te gjithe anetaret e Keshillit Kombetar. Eshte zhvilluar edhe nje seminar nga BSPSH dhe AFL-CIO me Institutin e Punes prane BSPSH. Ajo eshte botuar ne dy numra te Revistes sone "Tribuna sindikale" dhe ne besojme se ne qofte se ajo do te ishte shperndare regullishte, sot Kontraten do ta kishte çdo shkolle. Ne shumicen e qarqeve, por dhe ne rrethe, jane lidhur kontrata te nivelit te dyte, por fatkeqesishte jo te gjithe e njohin kontraten kolektive gje qe vlen dhe per antaret e Kryesise. Per vitin e ardhshem kesaj pike do t'i kushtohet vemendje me e madhe, njekohesishte do te grumbullohen verejtjet dhe gradualishte te depozitohen nga Z Defrim Spahiu propozimet me kerkesat qe grupe mesuesish apo individ te vecante kane per kontraten e re. Mendoj qe ne cdo shkolle ne kendet e njoftimeve te vendoset Kontrata Kolektive, e drejte kjo e fituar ne lirite sindikale. Kryesia te parashikoje per vitin e ardheshem seminare per njohjen dhe per partneritetin social me DAR apo ZA ne ato organizata qe kane nevoje, por qe edhe e kerkojne, me qene se jane te riorganizuara rishtas.

Nje teme tjeter shume e rendesishme qe zhvilluam ne qershor dhe qe duhet ta vazhdojme edhe vitin e ardhshem eshte krijimi i organizmave te qendrueshme gje qe kerkon angazhimin e antarit dhe te drejtuesit sindikal. Deshiroj te vleresoj punen e drejtuesve ne disa rrethe si Korca ,Tirana, Lushnja, Elbasani, Dibra me perfaqesuesit e tyre; Albina Pepo, Rejhan Shkreta, Luan Zonja, Bukuroshe Shabani, Ismet Spahiu, por jane ne zhvillime pozitive edhe rrethet Tropoje, Tepelene, Kolonje, Devoll, Lezhe, Delvine, Tirane rreth, Vlore, Kucove, Puke, etj.

Nje ndihme shume te madhe ne realizimet tona per vitin 2007 ka qene zhvillimi shume i suksesshem i projektit te dy sindikatave shqiptare te arsimit, SPASH e FSASH me FNV, AOb Holande.

Kater kane qene shtyllat kryesore te bashkepunimit, ne kuadrin e ketij projekti:

- Fuqizimi i sindikatave nepermjet rritjes se numrit te anetarve, shtimit te te ardhurave nga kuotizacioni, qe per ne rezulton nje rritje reth 1 000 antare me kuote, konsolidimit te strukturave lokale, ngritjes se kapaciteteve, dhe informimit te antareve.

- Angazhimi i veçante per problemet e grave mesuese, permiresimit te pozites tyre ne arsim dhe te pjesmarjes ne sindikate.

- Angazhimit te sindikates dhe mesuesve per parandalimin dhe eleminimin e punes se femijve.



- Zgjerimi i komunikimit dhe ndergjegjesimi i mesuesit anetar te sindikates per domosdoshmerine e anetaresimit dhe pjesemarrjes aktive ne aktivitetet sindikale

Diskutantet, anetare te Keshillit Kombetar, qe e moren fjalen, mbeshteten konstatimet e kryesise dhe vune ne dukje, jo vetem arritjet, por edhe problemet me te cilat ata ndeshen cdo dite, duke premtuar nje anagzhim me efektive te strukturave ne baze, por edhe duke kerkuar nje angazhim me efektiv edhe te strukturave qendrore, sidomos per te realizuar nje partneritet me efektiv me MASH, me DAR dhe Za.

TRIBUNA E SPECIALISTIT

Duke filluar nga ky numur, te nderuar lexues, Redaksia do te botoje per ju mendime te specialisteve per probleme te pagave, shperblimeve, pensioneve, mbrojtjes ne pune dhe do t'u pergjigjet pyetjeve te sindikalisteve.

Kete rubrike po e hapim me disa pyetje te mësuesit në pension Bardhyl Gjylbegu dhe pergjigjet që jep specialisti z. Fadil Kepi, pergjigje te botuara edhe ne Gazeten « Mesuesi ».

1. Sa përqind shtesë mbi pension përfiton një mësues, kur punon më shumë vite se sa kërkohet?

2. Kam dy fëmijë në shkollë; a më takon shtesë pensioni?

3. Deri sa vjet u njihet femrave vjetërsi pune për pension pleqërie shkolla e lartë?

4. Gruaja ime është e datëlindjes 22.08.1952, është arsimuar për mësuesi, por është larguar disa vjet nga puna në arsim per motive politike. Ajo ka punuar 8 vjet punëtore dhe nga viti 1991 punon si mësuese. Cilat janë kushtet për të përfituar pension si mësuese dhe me që ka 24 vjet punë gjithsej, mund të vazhdojë të punojë mbi moshën e pensionit deri sa t'i bëhen 35 vjet punë për të përfituar pension të plotë?

Përgjigje:

1- Mbështetur në nenin 33 të ligjit të sigurimeve shoqërore, punonjësit e siguruar që kanë plotësuar moshën e pensionit dhe vitet e punës së siguruar, sipas gjinisë dhe kategorisë së punës ku kanë punuar, përfitojnë 4 përqind shtesë pensioni për çdo vit që shtyhet dalja në pension ose 0,34 përqind shtesë pensioni për çdo muaj, kur punonjësi ka punuar mbi moshë dhe mbi vitet e punës që duhen për të marrë pension të plotë dhe ka paguar rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetësore.

Për shembull, një mësuese femër nga data 1.7.2007 deri me 30.6.2008 për të përfituar pension të plotë, duhet të plotësoj tre kushte:

-moshën 57 vjece të vërtetuar me çertifikatën personale me fotografi të marrë nga gjendja civile,

-të ketë punuar e siguruar 35 vjet përfshi dhe shkollën e lartë ditën (një vite shkollë baras me një vit punë) e dokumentuar me kopjen e diplomës së noterizuar.

-tre të katërtat e 35 vjeteve të punës baras me 26 vjet e 3 muaj të ketë punuar mësuese. Nëse këtë mësuese, për nevoja pune drejtoria arsimore e mban në punë mbi moshë edhe një vit, ajo do të dalë në pension 58 vjece dhe do t'i bëhen 36 vjet punë, ose një vit më shumë se 35 vjet, që kërkohen për të marrë pension të plotë.

Për këtë vit që ajo punoi mbi moshë dhe mbi 35 vjet punë do të marrë 4 përqind shtese pensioni, kur punon dy vjet më shumë përfiton shtesë pensioni 8 përqind, etj.

Ky kriter ndiqet edhe për mësuesit meshkuj, kur punojnë mbi moshën e pensionit me përjashtim se ata moshën për pension të plotë deri me 30.6.2008 e kanë 62 vjeç.

2.-Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.703, datë 27.12.2001, botuar në faqen 201 të legjislacionit të sigurimeve shoqërore të vitit 2003, kur dy prindërit janë në pension, marrin gjithsej 414 lekë në muaj kompensim për çdo femijë, që është në shkollë ditën, deri në moshën 25 vjeç, nga të cilat 207 lekë i merr shtesë mbi pension njëri prind dhe 207 lekë prindi tjetër. Nëse është vetëm një prind në pension vetëm ai ose ajo do të marrë shtesë mbi pension 207 lekë, për secilin fëmijë që vazhdon shkollën dhe jo prindi tjetër që nuk është pensionist.

3.-Bazuar në nenin 37 të Ligjit Nr.9377, datë 21.4.2005, botuar në Fletoren Zyrtare 37, "Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për femrat, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet deri në 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt të pensionit të pleqërisë. Në këto raste një vit shkollor, për pension quhet 12 muaj".

4.-Si mësuese, bashkëshortes së Z.Bardhylit i takon të dalë në pension 58 vjeçe e 6 muaj me 22 shkurt të vitit 2011, nëqoftese në atë datë do të ketë 35 vjet pune gjithesej dhe nga keto 26 vjet e 3 muaj mësuese. Nëse në atë datë ajo nuk i plotëson të tre kushtet e mësipërme do të përfitoj pension në moshën 60 vjeçe jo si mësuese dhe po të ketë me pak se 35 vjet pune të siguruara gjithesej do te marrë pension të pjesshëm.

Të drejtën për ta mbajtur në punë mbi moshën e pensionit e ka vetëm Drejtoria Arsimore Elbasan, duke mbajtuar parasysh edhe vështirësitë që krijohen për këtë, nga kërkesat e shumta për t'u punësuar si mësueses në rrethin përkatës.

Fadil Kepi

BAZA SINDIKALISTE MIREPRET TAKIMET ME DREJTUESIT QENDROR

(Shenime nga nje bashkebisedim i zhvilluar nga anetare te SPASH ne Shkollen 9 - Vjecare "Ymer Lale" Surrel, Qarku Tirane)

Keto dite, Kryetari i SPASH-it zoti Bajram Kruja dhe z. Gani Lami, Kryetar i BSPSH per Prefekturen e Tiranes, zhvilluan nje bashkebisedim me anetare te sindikates se pavarur te arsimit ne shkollen e mesme te bashkuar "Ymer Lale" Surrel. Ne qender te ketij bashkebisedimi ishin problemet qe shqetsojne mesuesit dhe sindikalistet dhe njohja e tyre me veprimtarite e SPASH dhe BSPSH.

Ne bashkebisedim u evidentua fakti se mesuesit sindikaliste dhe drejtuesit e shkolles jane te lidhur me profesionin e tyre, me nxenesit dhe komunitetin e zones.

U theksua se shkolla ka perfshire gjithe kontigjentin e nxenesve qe i nenshtrohen arsimit te detyruar 9 vjecar. Ne shkolle ka rregull e pasterti, si ne paraqitjen e jashtme te mesuesve dhe nxenesve, te cilet jane me uniforme te rregullt, gje qe tregon se ketu punohet me kembengulje e pasion nga te gjithe. Drejtori i shkolles z. Ibrahim Skera, i njohu te pranishmit me disa probleme te shkolles, ku nder te tjera theksoi se shqetesues eshte dhe mbetet rreabilitimi i nje pjese te shkolles, gje e cila u eshte bere prezent edhe strukturave lokale e qendrore. Prej tyre ka premtime, por deri tani nuk eshte bere asgje me perjashtim te hyrjes se shkolles. Nga mesuesit sindikaliste u kerkua qe kushtet e punes duhet te jene me te mira, sidomos ne paisjen e shkolles me laborator fizike e kimie per te konkretuzuar shpjegimin e ketyre disiplinave dhe per te rritur pervetesimin me cilesor nga ana e nxenesve.

Nga sindikalistet pjesemarres u kerkuan sqarime per pagen dhe elementet e saj perberes, per menyrat e motivimit te mesuesve te dalluar, per moshen e daljes ne pension, per veshtersite e punes etj.

Z. Bajram Kruja iu pergjigj ketyre shqetsimeve dhe parashtroi punen qe ben SPASH per t'i zgjidhur ato ne kuadrin e objektivave dhe marredhnieve qe sindikatat e arsimit kane me Ministrine e Arsimit dhe Shkences. Ai i njohu, gjithashtu, sindikalistet me disa nga aktivitetet e SPASH-it, ku theksoi punen e bere me nxenesit qe braktisin shkollen dhe vuri ne dukje punen e mire te mesuesve sindikaliste per te eleminuar kete fenomen, pavarsisht nga kushtet e hallet qe ato kane nxenes te vecante. Z. Kruja theksoi se SPASH ka besim tek Qeveria se deri ne fund te mandatit 4-vjeçar pagat e mesuesve do te dyfishohen. Ndersa problemi i vjetersise ne arsim qe ajo te njihet si vjetersi ne pune do te luftohet per ta zgjidhur sic eshte percaktuar ne kontraten kolektive te nivelit te pare te nenshkruar me 4 korrik 2006 midis Ministrise se Arsimit e Shkences dhe dy sindikatave te arsimit, FSASH e SPASH, neni 8/7, ku parashikohet qe t'i propozohet qeverise qe kjo vjetersi te njihet si vjetersi ne pune dhe jo vetem vjetersi ne arsim.

Ai theksoi edhe per partneritetin qe duhet te ekzistoje midis Sindikates, Qarkut dhe Komunave e Bashkive, bashkepunim i cili duhet te funksionoje ashtu siç duhet, ku sindikata te njihet me buxhetin per arsimin qe miraton pushteti lokal,etj. Zoterinjte Gani Lami e Hysen Daja, duke ju pergjigjur pyetjeve te te pranishmeve per moshen e daljes ne pension, dhane shpjegimet perkatese.

Z Defrim Spahiu, zv/ kryetar i SPASH –it theksoi se sindikata eshte e fuqishme kur ka nje buxhet te fuqishem, kur çdo anetare zbaton statutin e SPASH- it, ku nje nder pikat eshte edhe pagesa e kuotizacionit mujor. Jo te gjithe e paguajne, por theksojme se edhe ato qe duan ta paguajne dhe kerkojne te mbahet ne bordero, nga ekonomistet e komunave nuk mbahet. Ne qarkun tuaj, nenvizoi ai, ka disa komuna qe nuk pranojne te mbajne kuotizacionin duke e zbritur nga paga ne bordero. Ne duhet te gjejme formen per te mbledhur kuotizacionin qofte dhe duke paguar direkt mesuesit sindikaliste nepermjet kryetareve te shkollave. Mesuesit tani jane pajisur me karten anetaresie dhe aty firmoset pagesa e kuotes nga kryetari i SPA- te qarkut.

Sindikalistet falenderuan te ardhurit nga qendra per bashkebisedimin e ngrohte dhe pergjigjet e pyetjeve dhe i ftuan per arkhje te tjera.

Shaban Duka
Kryetar i SPA- Qarku Tirane

MUNDESI ARSIMIMI EDHE PER NJEREZIT NE NEVOJE

(Ne shkollen e mesme te pergjithëshme "K.Kristoforidhi"-Tirane)

1

Ndoshta, shumëkush nuk e di se në një mjedis të zhurmshëm të qendrës së kryeqytetit tonë Tiranë, ndodhet edhe një shkollë e mesme e përgjithëshme (me kohë të shkurtuar), krejt e veçantë dhe unike në llojin e vet, në gjithe Republikën. Ajo mban emrin e atdhetarit e rilindësit tonë te shquar, Kostandin Kristoforidhi. Sigurisht, nismëtaret e këtij emri e kanë lidhur këtë gjë me misioinin e rëndësishëm, që do të kryente ajo. Sidoqofte, brezat e mësuesve e të nxënësve janë krenarë per udhën e përshkuar dhe çdo ditë tani (në sistemin treditor javor dhe në atë të korrespondencës) përpiqen ta mbajne me nder emrin e shkollës së tyre, duke i çuar më përpara arritjet, në të gjitha fushat.

Drejtori i kësaj shkolle, Munir Sina, një burrë i qetë, serioz dhe mjaft i lidhur me çështjet e arsimimit të brezit tonë të ri, tregon ngadalë e saktë për fillesat e këtij institucioni të veçantë arsimor, për episode të rëndësishme dhe për përkushtimin e sotëm të kolektivit mësues-nxënës. Në të gjitha punët e detyrat, ai ka kurdoherë bashkepunimin e të ërë kolegëve, por sidomos të tre zëvendësdrejtorëve, Suzana Gliozheni,

Vijon në faqen 14

Vijon nga faqja 13

Kujtim Stana e Pranvera Margariti.

Shkolla e mesme "K.Kristoforidhi" i çeli dyert e saj sapo u çlirua vendi, pra menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore (më parë ishte bashkë me Gjimnazin e Tiranës). Ajo u bë vatër e madhe e arsimimit të luftëtarëve të lirisë, të cilët i



kishin ndërprerë mësimet për një çështje tjetër më madhore. Në vitin 1965 kjo shkollë u nda dhe u bë më vete, ashtu siç është sot.

2

Misioni i kësaj shkolle ishte dhe mbetet të arsimojë e të edukojë me virtytet më të larta të popullit bijë e bija të tij, pa shkëputje nga puna, por që i kanë ndërprerë më parë studimet për arsye të ndryshme, sidomos për shkaqe ekonomike, pra që janë në nevojë. Gjithashtu, ndër ta ka edhe të rinjë sportistë, pjesëmarrës në veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, që janë të detyruar të mos i ndjekin rregullisht mësimet dhe të mos bëjnë mungesa, ashtu siç e kërkon rregullorja e një shkolle të zakonshme. Siç na pohon drejtori, është e rëndësishme që kjo shkollë tani i përballon të gjitha nevojat e metropolit të Tiranës, për këto dy kategori nxënësish. Ndërtesa e rikonstruktuar, me klasa mësimi, laboratorë etj. i plotëson më së miri kushtet për një shkollë normale.

Sivjet në shkollën "K.Kristoforidhi" i vazhdojnë mësimet 630 nxënës, në sistemin tredidor javor dhe afër 1.470 të tjerë, në sistemin e korrespondencës, i cili bazohet në studimin vetjak dhe konsultimet pranë shkollës. Ndër ta, përmendim edhe 4 matura, nga dy për çdo sistem, me afër 170 nxënës. Në shërbim të tyre janë venë 21 mësues e mësuese, që nuk i kursejnë energjitë mendore as fizike për t'i bërë sa më të vlefshëm për veten e për shoqërinë.

Sistemi 3-ditor këtu është i vetmi, që funksionon në vendin tonë, ndërsa me korrespondencë i vijojnë mësimet, në shkolla të mesme edhe në çdo qendër rrethi.

Kur interesohesh të dishë më shumë për jetën e këtij kolektivi, njihesh edhe me disa objektiva e pikësynime. Në mes tyre, na tërhoqi vëmendjen objektivi që pas provimeve të maturës shtetërore, të rritet më tëj numri i maturantëve, që konkurojnë dhe që i ndjekin studimet në degë të ndryshme të universiteteve. Nxitëse për mësuesit e nxënësit është fakti se, në këtë vit akademik, janë edhe 42 ish-maturantë të kësaj shkolle, që i vazhdojnë shkollat e larta. Synohet që vitin e ardhshëm ky numër të shkojë në 60 e më tepër. Sigurisht, kjo gjë nuk është arritur lehtë, po të kemi parasysh se në vitet e para regjistrohen edhe nxënës, të cilët nuk i kanë përballuar kërkesat në shkollat e mesme të rregullta.

3

Është e ditur që çdo shkollë ka shqetësimet e veta, veçoritë e objektivat, sigurisht të përafërta. U njohëm edhe me një shqetësim të natyrshëm të drejtuesve e mësuesve. Nxënësit e dy sistemeve, deri tani, janë paraqitur para një komisioni me 3 veta, për t'u përgjigjur lidhur me njohuritë e fituara. Por kjo praktikë mund të krijojë rrugë e mundësi për abuzime ose korrupsion. Prandaj është menduar që provimet e mëtejshme të zhvillohen vetëm me shkrim, pra duke u dokumentuar mirë çdo provim i nxënësit.

Pikësynim tjetër i këtij kolektivi është rritja e kalueshmerisë reale dhe e cilësisë së notës. Në vitin arsimor 2005-2006, në të dyja sistemet, kaluan 89% e nxënësve të regjistruar, përfshirë ata të provimeve të vjeshtës. Po kështu, mbetet problem vijueshmëria e rregullt dhe ulja e numrit të mungesave, sidomos në orët e para të mësimit. Objektivi është që numri i mungesave mesatare vjetore të ulet nga 67, që ishte vjet, në 45 e më pak. Ndërsa mungesat vjetore me arsye të ulen, nga 47 në 30, mesatarisht për çdo nxënës etj.

Po si do të arrihen objektivat, si do të përmbushen dëshirat e mësuesve, nxënësve e prindërve, për të siguruar kalueshmëri sa më të lartë dhe cilësi në përvetësimin e njohurive? Këtyre pyetjeve u përgjigjen jo vetëm drejtuesit, por dhe mësuesit e përkushtuar në detyrën e tyre të përditëshme. Po përmendim vetëm emrat e disave prej tyre, duke qenë të ndërgjegjshëm se kemi lënë mjaft të tjerë, që e meritojnë plotësisht. Kolegë, nxënës e prindër flasin fjalët më të mira për mësuesit: Petrit Xhaja (matematikë), Dr. Bajram Salianji e Teuta Kujunxhi (fizikë), Dhora Papa (letërsi) e Mariola Hicka (filozofi). Në ndihmë të drejtuesve e mësuesve janë venë edhe Qeveria e Nxënësve, Bordi i Shkollës etj.

...Në fund, dëshirojmë të shtojmë ndonjë çështje, që kërkon zgjidhje sa më të shpejtë. Para dy vjetësh dilte gazeta e kësaj shkolle, që pasqyronte jetën e gjallë të saj. Ndërsa tani ajo nuk botohet më, por thuhet se kjo gjë do të zgjidhet me fillimin e vitit të ri 2008. Me rëndësi është dhe pasurimi i mëtejshëm i fondit të librave në bibliotekë, pasi tani ai lë shumë për të dëshiruar dhe dihet roli që ato luajnë në jetën e nxënësve.

Sindikata e mësuesve, e cila ka qene aktive ne shkolle, jo vetem per mbrojtjen socile ekonomike te mesuesve, por edhe per mbarevajjen e punes ne shkolle, eshte e ndergjegjshme se ka detyra te rendesishme perpara per te kryer si duhet rolin e partnerit social ne menyre te efektshme dhe reale. Kështu, ajo do të ndihmojë fuqishëm që të plotësohen sa më mirë të gjitha objektivat në fushat e mësimdhënies dhe edukimit të nxënësve.

Murat Gecaj

Të reja shkencore

Material mbrojtes per çilklistet

Çiklistët jamë më të sigurt nëse përdorin kasketa, por "Dow Coming" ka realizuar një "kostum mbrojtës" për çiklistët dhe "guximtarët" e sporteve të tjerë. Materiali i përdorur në Sistemin Mbrojtës të "Dow Coming" është i butë dhe fleksibël deri në momentin para impaktit. Përballe ndonje goditjeje te



cfardo lloji, ai kthehet në një material të fortë, jo vetëm në zonën ku ka ndodhur përplasja, por në të gjithë hapësirën e trupit që mbulohet nga ky material. Kur kthehet përsëri i butë, në gjendjen normale, mund të lahet dhe të përdoret përsëri. Jo vetëm çiklistët, por edhe sportistët e tjerë mund të mbrohen nga dëmtimet, duke përdorur këtë copë.

Mbështetësi i kokës "Toyota"


Toyota, një kompani jo pa emër, ka dalë në treg me një pajisje sigurie që merr përsipër të ulë dëmtimet nga përplasjet dhe ndoshta të shpëtojë edhe jetë. Quhet Sistemi i Pararojës. Një sistem radari, i instaluar në parakolp te makinës, hyn në funksionim kur ndodhet një milimetër pranë makinës, 2 sekonda para se dicka tjeter t'ju godasë. Ky sistem ndez dritat e rrezikut, shtrëngon rripin tuaj të



sigurimit dhe aktivizon mbështetësin e kokës që është dhe në figurë, duke e zhvendosur para për të parandaluar që koka juaj të bjerë me forcë mbrapa, pas përplasjes.

Filmi i hollë me pore (FNTF)

Nga ana muzikore mund t'ju pëlqeje "heavy metal", (metal i rëndë), por, kur bëhet fjalë për ujin e pijshëm, asnjë nuk e do të pranishëm. Laboratori Kombëtar i Pacifikut Veriperëndimor ka realizuar një film të hollë me pore, (FNTF), që funksionon si një letër e hollë që tërheq metalet e dëmshme në ujin e pijshëm. Kur FNTF hiqet nga uji, atëherë Spectroscopi fluoreshent me rreze X, (XRF), mund të përdoret për të dalluar metalet qe kanë ngelur në film. Kombinimi i këtyre teknologjive bën që të dallohet pothuajse çdo metal i padallueshëm, edhe kur ndodhet



në sasira shumë të vogla në përbërje të ujit të pijshëm.

Keshilla praktike

DHJETË GJËRA QË DUHET TË EVITONI KUR KËRKONI NJË RRITJE RROGE

Thënia e gjërave në një mënyrë të gabuar në çfarëdolloj negociatash mund të krijojë barriera që mund të mos kapërcehen asnjëherë. Sa herë na ka ndodhur që dikush të thotë gjënë e gabuar në mënyrën e gabuar dhe ju keni vendosur që nuk ia vlen. Është e trishtë por kjo ndodh gjithmonë.

Të kërkuarit e një ngritjeje në pozicion kërkon aftësi, pregatitje dhe kohë. Shumë punonjës e marrin lehtë këtë çështje duke marrë për të mirëqëne që ngritja bazohet në etikën e punës, angazhimet me orarin dhe madje edhe me çështjet personale. Punonjësit pothuajse asnjëherë nuk janë në dijeni të dinamizmit të vendit të punës, si kualifikohen dhe si paguhen të tjerët. Të gjitha këto luajnë një rol të rëndësishëm.

Kur të jeni gati të kërkoni një ngritje në detyrë ja ku janë 10 gjëra që duhet të keni parasysh:

1. Evitoni t'i thoni punëdhënësit tuaj që shpresoni që ai të thotë "po"

Në vend të kësaj, tregojini që jeni i kënaqur edhe me një "jo" si përgjigje dhe doni që ai të jetë i qetë nëse përgjigja është "jo". Kjo bën që ai të mos ndihet në siklet

2. Evitoni të qënit emocional

Në vend të kësaj, flini mendjen. Mos kini shpresa ose frika. Siç dihet tashmë, nervozismi është shkatërruesi numër një i marrëveshjeve. Të qenit i qetë ju jep fuqi.

3. Evitoni të shkoni në takim të papërgatitur

Në vend të kësaj, bëni kërkime për mënyrën dhe pagesën e kolegëve të tjerë në të njëjtin pozicion. Zbuloni pengesat që ndodhen në rrugën tuaj. A ka hequr njeri nga puna kompania kohët e fundit? A ka në plan të ketë një organizim të ri? Informohuni për të gjitha çështjet që mund ta bindin shefin tuaj për t'ju dhënë ngritjen në pagë që kërkoni. Listoni qartë të gjithë problemet që keni dhe kërkojini si mund t'i zgjidhni.

4. Evitoni përpjekjet për t'i bërë përshtypje shefit tuaj

Në vend të kesaj bëni që ai të ndihet tërësisht i qetë me ju dhe ndoshta edhe pak superior. Mos u vishni asnjëherë për të bërë përshtypje, mos u mburrni dhe mos kini pretendime.

5. Evitoni të bëni një prezantim të vetes

Në vend të kesaj flisni sa më pak të mundni. Pyeteni punëdhënësin tuaj për shumë gjëra, në mënyrë që të zbuloni pozicionin që ai mban, nevojat dhe objektivat që ka.

6. Evitoni të bëni pyetje që kanë për përgjigje "po" ose "jo"

Në vend të kësaj, nxirrjani pak nga pak të dhënat që kërkoni duke e filluar pyetjen me: kush, çfarë, kur, si dhe pse?

7. Evitoni të mendoni për të ardhurat

Në vend të kësaj, mos bëni plane për ngritje të mundshme. Fokusoni vëmendjen tuaj në atë që e keni në dorë vetë: sjelljen tuaj gjatë negociatave.

8. Evitoni që të tjerët të mendojnë se qëllimi juaj është të fitoni më shumë para

Në vend të kësaj, misioni dhe qëllimi juaj në këtë bashkëbisedim është të përmbushni nevojat dhe objektivat e punëdhënësit tuaj. Çdo vendim që merrni gjatë procesit të negociatave duhet të jetë i përqendruar në ndihmën që mund t'i jepni punëdhënsit në mënyrë që dhënia e një ngritje të jetë edhe në interes të tij.

9. Evitoni të paraqisni pagesën tuaj të momentit ose pozicionin tuaj si problem

Në vend të kësaj, prezantojeni veten si zgjidhja e problemit. Mos kini frikë të jepni shembuj specifikë për sfidat që përballoni dhe zgjidhjet që siguroni. Detyra të veçanta që i përshtaten vizionit të punëdhënësit duhen spieguar dhe diskutuar. Sa më shumë shembuj të jepni, më mirë.

10. Mos jepni ultimatume

Në vend të kësaj, vazhdoni të negocioni. Mos e kërcënoni asnjëherë, me tipin, "ose po, ose ika", duke i thënë për një punë tjetër që mund t'ju kenë ofruar. Përdorni zë të qetë dhe të ulët. Përmendini problemet qartë dhe mos kini frikë për të pyetur. Sa më efektiv të shfaqeni kur diskutoni për zgjidhjen e problemeve, më mirë do ishte.

Përgatiti faqen Eriona Vangjeli

Tribuna sindikale

